

Programi i Integruar i Ciklit të Dytë të Studimit “Master Shkencor” në “Mjekësi Veterinare”, (300 ECTC, 5 vite akademike, me kohë të plotë)

Programi i Studimeve me Karakter Profesional 2–Vjeçar: Menaxhim Veterinar, (120 ECTC, 2 vite akademike, me kohë të plotë)

Fusha e Studimit është **Shkenca Agrikulturore dhe Veterinarisë**.

Fakulteti i Mjekësisë Veterinare ofron studime në Programin e Integruar të Studimit në “**Mjekësi Veterinare**”, që përfshihet në programet e studimit “Master i Shkencave” dhe programin e studimit me karakter profesional 2-vjeçar “**Menaxhim Veterinar**”.

Profili profesional (Mjekësi Veterinare)

Ky program studimi synon të japë aftësim profesional studiuesve të ardhshëm në fushën e edukimit veterinar. Programi ka si funksion kryesor edukimin teorik dhe praktik të mjekëve veterinarë të ardhshëm. Programi ka për qëllim përgatitjen e mjekëve veteriner dhe zhvillimin e mëtejshëm të veprimtarisë studimore, kërkimore e shkencore. Misioni i përgjithshëm i Programit të Studimit në “Mjekësi Veterinare” është të edukojë veterinerë të kualifikuar, të cilët do t'i shërbejnë shoqërisë përmes përpjekjeve të tyre të qëndrueshme për të përmirësuar shëndetin e kafshëve dhe njerëzve. Pas përfundimit të programit të integruar universitar në mjekësinë veterinare, studentët fitojnë aftësi dhe kompetenca profesionale për: trajtimin e kafshëve, zgjidhjen e çështjeve në shëndetin publik veterinar, mbrojtjen e njeriut dhe mjedisit, diagnostikimin në terren, klinik dhe laboratorik, luftimin parandalues të sëmundjeve infektive dhe zoonozave, planifikimin dhe pjesëmarrjen në programet për zhvillimin dhe përmirësimin e kushteve në fermat blegtorale dhe prodhimin e ushqimit me origjinë shtazore, zhvillimin e të gjitha formave të mbrojtjes së kafshëve dhe mjedisit, dhe etikën në komunikim dhe marrëdhëniet ndaj kafshëve.

Profili profesional (Menaxher Veterinar)

Në Programin me Karakter Profesional “Menaxhim Veterinar” trajnohen specialistë për të punuar profesionalisht si pjesë e një ekipi veterinar dhe gjithashtu brenda sektorëve të përfaqësuar. Ky program është ideal për ata studentë që dëshirojnë të ndjekin një karrierë që përfshin menaxhimin e praktikës veterinare.

Modulet kryesore të trajtuara përgjatë studimeve të këtij programi:

Programi i Studimit në “Mjekësi Veterinare” është përshtatur sipas Direktivës 2005/36/EC në përputhje me strukturën e Bolonjës. Gjatë dy viteve të para (paraklinike) studentët studiojnë Anatomji, Histologji, Biologji, Kimi, Fizikë, Fiziologji, Biokimi, Etologji, Botanikë, Biostatistikë, si dhe bazat e të ushqyerit dhe mbarështimit të kafshëve etj. Gjatë tre viteve të ardhshme (paraklinike + klinike), studimet i japin studentit një pasqyrë për proceset që ndodhin në

organizmin e kafshës së sëmurë, si dhe aftësitë elementare në diagnostikimin e sëmundjes. Programi përqendrohet në marrëdhëniet midis shëndetit të njeriut dhe kafshëve dhe në çështjet e shëndetit publik. Modulet e trajtuara përgjatë studimeve të këtij programi kanë për qëllim tu ofrojnë studentëve një programit orientues që bazohet në lëndë formuese për të garantuar standardet e miratuara dhe të pranueshme të mjekut veteriner. Në të ka një shpërndarje të saktë të ngarkesës mësimore duke u mbështetur në planet mësimore dhe silabuset e lëndëve.

a. Formim i përgjithshëm

Modulet e formimit të përgjithshëm kanë për qëllim orientimin e profesional të studentëve drejt Mjekësisë Veterinare dhe realizohen përgjatë dy viteve të para të studimit. Modulet e formimit të përgjithshëm mundësojnë zhvillimin dhe thellimin e mëtejshëm të njohurive në lëndët e Kimisë, Biologjisë, Informatikës si shkencat bazë natyrore të cilat kanë për funksion krijimin e shprehive dhe shkathtësive gjatë punës teorike dhe praktike, njohjen me metodologjinë statistikore dhe definicionet në informatikën mjekësore duke mundësuar përpunimin dhe prezantimin e të dhënave.

- Terminologji Mjekësore
- Gjuhë e Huaj
- Informatikë dhe Biostatistikë

b. Formim bazë karakterizues

Modulet bazë karakterizuese kanë si objektiv të ofrojnë njohuri themelore të edukimit veterinar. Modulet ofrojnë një informacion të thelluar duke përfshirë strukturën qelizore, strukturën indore si dhe strukturën e organeve dhe sistemeve të organeve.

- Kimi inorganike dhe organike
- Biologji & Biologji molekulare
- Biofizikë
- Sistematika e bimëve dhe kafshëve
- Hyrje në Anatomi
- Anatomi topografike
- Anatomia e aplikuar
- Histologji & Embriologji

Modulet karakterizuese zhvillohen mbas përfundimit të studimit të moduleve formuese dhe bazë. Këto module fokusohen në speciet kryesore me interes veterinarë, siç janë gjedhi, të imtat, kuajt dhe kafshët e shoqërimin dhe zhvillohen gjatë tre viteve të fundit të studimit. Modulet karakterizuese ndahen në disa grupe kryesore: 1) Module të cilat studiojnë funksionet jetësore themelore të organizmit si tërësi dhe të organeve dhe indeve në veçanti, duke mundësuar kështu

arritjen e njohurive themelore për kuptimin e proceseve fiziologjike dhe biokimike. Në të njëjtën kohë ato japin parimet bazë të metabolizmit dhe një vështrim të strukturës dhe funksionit të molekulave dhe të proceseve të rëndësishme metabolike që ndodhin brenda qelizave; 2) Module që studiojnë agjentin patogjen të aftë të shkaktojë patologjinë siç mund të jenë mikrobe, viruse dhe parazitë; 3) Module që studiojnë patologjitë specifike sipas specieve të cilat kanë qëllim formues dhe bazohen në gjykimin e përgjithshëm të gjendjes klinike të kafshës gjatë kontrollit. Në vetvete modulet karakterizuese synojnë të vendosin një diagnozë të saktë klinike në përcaktimin e patologjive nga të cilat mund të vërehen gjatë ekzaminimit klinik; 4) Lëndët që fokusohen në sigurinë ushqimore të cilat e vënë theksin në rolin parësor që luan mjeku veteriner në shëndetin e popullatës.

Biokimia Veterinare	Fiziologjia Veterinare
Mikrobiologjia Veterinare	Virologji dhe Imunologji
Higjienë Veterinare	Imazheri Veterinare
Patologji e përgjithshme	Farmakologji dhe Farmakologji Klinik
Patologji e veçantë	Sëmundje Infektive dhe Epidemiologji
Iktiopatologji	Riprodhimi i kafshëve
Kirurgji Veterinare	Sëmundjet e ripërtypësve
Sëmundje e kafshëve të Shoqërimit	Sëmundjet e Derrave
Sëmundjet e njëthundrakëve	Inspektimi i produkteve me origjinë shtazore
Parazitologji veterinar	Sëmundjet e kafshëve të egra
Toksikologji veterinar	Sëmundjet e shpendëve

c. Formim integruar.

Module integruar kanë për funksion njohjen e koncepteve të metodologjisë së kërkimit shkencor, studimit dhe prezantimit të punimeve shkencore dhe shfrytëzimin dhe kërkimin e literaturës për punime shkencore. Në të njëjtën kohë ato ofrojnë dhe koncepte mbi Diagnostikën Veterinare, Etiologji dhe Mirëqenien e Kafshëve dhe Gjenetikën. Modulet e karakterit zooteknik fokusohen në racat dhe ushqyerjen e kafshëve.

- Gjenetikë
- Etologji dhe Mirëqenie e kafshëve
- Diagnozë Laboratorike
- Metodologji Shkencore dhe Shkrim Akademik
- Propedeutika Veterinare

- Zootekni
- Të ushqyerit e kafshëve
- Legjislacion dhe mjekësi ligjore veterinare
- Lëndë me zgjedhje

Formimi veterinar bazohet edhe në realizimin e Praktikës Profesionale e cila përbën një komponent të rëndësishëm të kurrikulës së programit të “Mjekësisë Veterinare”. Ajo synon t’u japë studentëve një përvojë praktike në përfundimin e studimeve dhe bazohet në realizimin e praktikës profesionale në klinika veterinare private, ferma blegtorale, depo dhe farmaci veterinare, Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, Agjencinë Kombëtare të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoritetin Kombëtar të Ushqimit (AKU). Praktika parashikon të mundësojë përdorimin e kompetencave të fituara përgjatë kurseve teorike në një kontekst praktik profesional. Ajo ka për qëllim të aftësojë studentët me konceptet bazë në veprimtarinë praktike duke u bazuar tek aplikimet e ndryshme klinike.

Mundësitë për punësim

Tregu i punës në këtë sektor ofron shumë mundësi punësimi për mjekët veteriner menjëherë pas diplomimit. Tregu i punës për profesionin e veterinerit është i lidhur ngushtë si me sektorin privat dhe me atë shtetëror. Shumë veteriner preferojnë të punojnë si veteriner terreni privat në komunat nga ku ata vijnë.

– Sektori privat, ku një pjesë e rëndësishme e mjekëve veterinerë punojnë si profesionistë të lirë në klinika veterinare, farmaci, laboratorë dhe spitalet veterinare. Ata punojnë individualisht ose në bashkëpunim, duke mbuluar të gjithë territorin e vendit me një rrjetë klinikash veterinare ose me shërbimin e tyre ambulator. Një pjesë e mirë e tyre merren me kafshët e shoqërimit (*qen, mace, kuaj dhe të tjera*). Pjesa tjetër kujdeset ndaj kafshëve të prodhimit (*gjedhë, dele, dhi, derra, shpendë, peshq*).

- Mjekë veteriner privatë në terren,
- Mjekë veteriner në klinika veterinare,
- Depo farmaceutike veterinare,
- Farmaci veterinare,
- Laboratorë të ndryshëm privatë veterinarë,
- Komplekse të ndryshme blegtorale, si pulari, të rritjes së derrave, komplekse të rritjes së gjedhit për mish/qumësht,
- Fabrikat e prodhimit të qumështit, sallameve etj.

– Sektori publik, përfshirë këtu nivelin e qeverisjes vendore, duke filluar nga bashkitë, komunat,

po ashtu në nivel qarku apo rajoni. Mundësitë e punësimit po ashtu janë dhe në institucione të qeverisjes qendrore:

- Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU),
- Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural,
- Fakulteti i Mjekësisë Veterinare,
- Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Veterinar,
- Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

Në përbërje të sektorit të Shërbimit Veterinar publik janë:

- Inspektorët e shëndetit të kafshëve, identifikimit, epidemiologjisë dhe të riprodhimit;
- Inspektorë të shëndetit publik veterinar;
- Inspektorë të pikave të inspektimit veterinar kufitar;
- Shërbimi veterinar laboratorik.

– Institucionet kërkimore shkencore vendase dhe të huaja të cilat kanë për fokus fushën e mjekësisë veterinare apo fusha të lidhura me të. Në të njëjtën kohë, gjatë viteve të fundit disa mjekë veterinerë janë punësuar dhe në klinika të ndryshme veterinare në Evropë. Mundësitë e punësimit përfshijnë po ashtu OJF, organizata ndërkombëtare.

- Projekte të Bashkimit Evropian
- OBSH
- FAO
- EFSA (European Food Safety Authority)